




Maj 2020

MONITORIMI I BASHKIVE

NË LIDHJE ME MASAT E NDËRMARRA NË KUADËR TË PANDEMISË COVID – 19

📍 Tiranë 📍 Durrës 📍 Kukës 📍 Kamëz 📍 Pogradec 📍 Shkodër 📍 Vlorë 📍 Fier 📍 Pukë



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



TABELA E PËRMBAJTJES

3 HYRJE

4 METODOLOGJIA

4 GJETJE KRYESORE DHE REKOMANDIMET SIPAS BASHKIVE

4 BASHKIA TIRANË

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

7 BASHKIA DURRËS

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

10 BASHKIA KUKËS

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

12 BASHKIA KAMËZ

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

14 BASHKIA VLORË

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

17 BASHKIA POGRADEÇ

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

19 BASHKIA SHKODËR

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

22 BASHKIA PUKË

Gjetje nga përgjigjet e bashkisë

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

24 BASHKIA FIER

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Rekomandime

Ky raport është Përgatitur nga Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike" në kuadër të projektit POP 2020 *"Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal"* të mbështetur nga Olof Palme Centre International, përmes mbështetjes financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë Suedeze ose të Olof Palme International Centre.

HYRJE

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura. Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike - POP", synon të rrisë debatin publik dhe përçojë informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioritetëve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: "Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social". Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- "Epoka e Re", Fier;
- "Intelektualët e Rinj Shpresë", Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me "Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal." Gjatë fazës së parë të kësaj nisme POP synon që të llojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratat Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimarrje.

Por, mes situatës së krijuar nga COVID-19, anëtarët e rrjetit POP përshtatën aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit që këto organizata përfaqësojnë.

Gjatë muajve mars dhe prill 2020, organizatat patën si qëllim:

- Të monitorojnë Këshillat Bashkiakë dhe veprimtarinë e bashkive për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojnë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llojnë dhe advokojnë për përmbushjen e prioritetëve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

METODOLOGJIA

Për të realizuar raportin, organizatat anëtare të POP u bazuan në metodat më poshtë.

1. Në çdo bashki u dërgua një letër-kërkesë për informacion. Përgjigjet e kësaj letre janë në pjesën e analizimit të gjetjeve
2. U realizuan disa intervista cilësore me banorë të njësive të ndryshme, të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparëshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioritetëve të Kontratës Sociale.
3. U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
4. U monitoruan vendimet e keshillave bashkiakë në lidhje me masat e vetë bashkisë në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të këshillave bashkiakë.

GJETJE KRYESORE DHE REKOMANDIMET SIPAS BASHKIVE

● BASHKIA TIRANË ●

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

- Gjatë muajve shkurt dhe mars janë 4245 familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga Bashkia Tiranë, ndjekur nga 554 individë përfitues me statusin e jetimit dhe 205 viktima të dhunës në familje;
- 12761 invalidë pune nga të cilët 57% burra dhe 43% gra përfitojnë ndihmë;
- 2452 fëmijë me aftësi të kufizuar nga të cilët 53% djem 47% vajza përfitojnë ndihmë nga bashkia Tiranë;
- 340 familje nga të cilat 229 në zonat urbane dhe 111 në zonat rurale përfitojnë bonus qeraje;
- 2034 burra dhe 612 gra përfitojnë bonus qeraje pas tërmetit të 26 nëntorit 2019;
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, bazuar në donacione të njëpasnjëshme nga organizata e fondacione ka mundur të ndihmojë për çdo familje në nevojë të identifikuar në të 24 njësitë administrative nga të cilat përbëhet. Nga kjo ndihmë deri më 9 prill 2020 kanë përfituar në total 6440 familje, të ndara sipas njësive administrative;
- Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, përmbajnë produktet bazë të shportës si: miell, oriz, sheqer, makarona, vaj ushqimor, kripë, salcë domatesh, fasule, detergjent, sapun, dizenfektues, pampers;
- Përmbatja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasinë dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nuk ka ndarje gjinore për shumë nga të dhënat që morëm nga bashkia Tiranë. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikpamja gjinore.
- Ndarja gjinore pasqyrohet për nënkategoritë: a) Invalidë Pune b) Fëmijë me aftësi të kufizuar.
- Nuk ka shtim të pagesave për personat me aftësi të kufizuar si dhe për ata me ndihmë ekonomike gjatë muajit mars 2020.

- Drejtoria e Shërbimeve sociale bashkiake nuk disponon statistika gjinore për të rinjtë e të rejtat. Pasi në zbatim të vendimit nr. 236, datë 19.03.2020, të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", të rinjtë nuk janë ndër kategoritë e klasifikuara si shtresa në nevojë.
- Gjatë periudhës 10 Mars - 10 Prill, janë trajtuar 24 raste të reja të dhunës në familje dhe përveç tyre janë asistuar për plotësimin e nevojave të tyre edhe 25 raste të tjera dhune të cilat janë nën menaxhim dhe kujdes nga muajt e mëparshëm;

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

- Familjet në nevojë të kontaktuar shprehen se kriza COVID-19 e ka bërë edhe më të vështirë mbijetesën e tyre. Pakot ushqimore të shpërndara nga pushteti vendor sipas tyre nuk janë të mjaftueshme dhe periudha e shpërndarjes duhet të jetë më e shpejtë.
- Anëtarët e Komunitetit Rom & Egjiptian paraqiten si kategoria e cila më shumë nga të gjithë po e vuan situatën e pandemisë. Nga hulumtimet e kryera dhe nga intervistat e drejtpërdrejta 1 në 5 familje ka përfutur pako ushqimore, të cilat sipas tyre nuk janë të mjaftueshme.
- Përsa u përket pensionistëve, në përgjithësi pensionet ju shkojnë në shtëpi nga posta qendrore në bashkëpunim me njësitë administrative respektive. Por edhe fqinjët kanë ndihmuar në shumë raste.
- Gratë të cilat punojnë me ditë pranë familjeve të ndryshme për pastrim shtëpie që nga data 9 mars kanë mbetur pa të ardhurat kryesore për të mbajtur familjet, por disa prej tyre informojnë se ndihma ekonomike e dyfishuar ju ka ardhur në ndihmë.
- Një shtresë që po vuan për shkak të pandemisë dhe akoma nuk ka marrë vemendjen e duhur janë gratë punëtore të fasonerive. Asnjë prej 10 grave të intervistuar nuk ka marrë ndihmë apo "pagë lufte", ndërkohë që 3 nga 10 kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe janë në pritje të përgjigjeve nga njësitë administrative përkatëse.
- Personat me aftësi të kufizuar si dhe ata që përfitojnë KEMP nga shteti raportohet se 2 nga 5 kanë përfutur pako ushqimore falas si dhe kempin nuk iu është ndërprerë;
- Shërbimet sociale pranë bashkisë Tiranë, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, lidhur me masat e marra në mbështetje të individëve dhe familje në nevojë përballë emergjencës së COVID-19, ka mundur identifikimin dhe kontaktimin e individëve/familjeve në nevojë;
- Grupet e terrenit të patronazhimit në çdo njësi administrative/lagje, të cilat përbëhen nga stafe punonjësish sociale dhe vullnetarë, kanë përditësuar listat emërore të personave nën patronazhim (deri në datë 9 prill 2020);
- Shërbimet sociale bashkiake, si pjesë e skemave të mbrojtjes sociale, kanë identifikuar 277 individë që kanë statusin e jetimit dhe ashtu si dhe kuadri ligjor përcakton, ata janë trajtuar me prioritet me programet e arsimit, punësimin, strehimit dhe kujdesit social;
- Sipas intervistave të kryera në njësitë administrative urbane, sidomos me prindërit kuptohet se fëmijët nuk kanë hasur vështirësi në ndjekjen e leksioneve, por theksi bie në cilësinë, nxënien dhe frikën për provimet. Frikë kjo e cila ka ndjekur gjatë këtyre dy muajve edhe maturanët dhe nxënësit e klasës së 9-të, për provimet e lirisë;
- Ndërsa në zonat rurale një numër shumë i madh i paidentifikuar nxënësish nuk mund ta ndjekin mësimin me aparate smart, por vetëm përmes programeve që jepen në RTSh.

Rekomandime

- Duke qenë se Pandemia COVID-19 është një fatkeqësi e një natyre e veçantë, presim nga Bashkia Tiranë të krijojë një protokoll për këto raste të replikueshëm për bashkitë e tjera dhe që mund të përdoret në raste të ngjashme.
- Bashkia Tiranë duhet të aktivizojë të gjithë administratorët lokalë dhe stafet e tyre të identifikojnë dhe krijojnë në database për familjet dhe individët në nevojë.
- Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Tiranë duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike.
- Në raste të tilla ku mijëra familje rrezikohen nga varfëria, duhet të rishikohet buxheti për të ndihmuar këto familje e sidomos kategoritë të cilat nuk janë parashikuara në VKM-të e mëparshme për ndihmë të shtresave në nevojë.
- Identifikimi i kryefamiljareve, punonjëse të sektorëve si fasoneri, që kanë humbur punën dhe asistencë e tyre me ndihmë ekonomike deri në momentin e rifillimit të punës.
- Me anë të administratorëve të blloqeve të pallateve të merren masa për afishimin e mënyrave të kontaktit të bashkisë Tiranë për çdo problematikë nga grupet në nevojë apo pensionistët.
- Një plan i detajuar për ndihmën e komuniteteve Rom & Egjiptiane, sidomos për ato familje të cilat nuk kanë asnjë mundësi jetese përveç mbledhjes së plastikës dhe aluminit.
- Krijimi i mundësisë së bonusit të qerasë për të gjitha viktimat e dhunës në familje kur nuk janë mundësitë për ti akomoduar në Strehëzën Kombëtare.
- Forcimi i MKR-së dhe drejtimi i tyre për të qenë sa më aktivë dhe funksionalë në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe asaj gjinore.
- Lobimi në qeverinë qendrore për përfshirjen në VKM-të respektive të ndihmës edhe për target grupet si të rinjtë apo vajzat nëna.
- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm që edhe fëmijët e zonave rurale dhe ato të familjeve në nevojë të mund të pajisen me telefona smart, të cilat mund t'ua lehtësojnë mësimnxënien.

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

<https://popalbania.info/raporti-i-monitorimit-bashkia-tirane/>

● BASHKIA DURRËS ●

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

- Gjatë muajve Shkurt-Mars janë 184 familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga Bashkia Durrës, nga të cilët 120 janë burra, 14 janë me statusin të martuar, 6 të ve dhe 64 gra. Nga të dhënat e Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Durrës rezultojnë që nga ndihma ekonomike përfitojnë 37 të divorcuara nga të cilat 24 janë vajza të reja dhe 3 vajza nëna;
- 13 janë familjet që kanë një person autik në familjen e tyre dhe përfitojnë ndihmë ekonomike;
- 111 janë përfitues në zonat urbane dhe 73 në zonat rurale në Bashkinë Durrës nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë në Punë;
- 4261 janë personat të mbështetur nga skema e KMCAP (2337 janë burra përfitues/ 1924 gra);
- 2802 persona që marrin nga KMCAP rezultojnë në zonat urbane dhe vetëm 1459 janë në zona rurale;
- Bazuar në të dhënat e përpunuara nga monitorimi ashtu edhe në mbështetje të vendimeve të Këshillit Bashkiak Durrës rezultojnë që nga: 5451 familje aplikuese për bonusin e qerasë në kuadër të mbështetjes si pjesë e fatëkeqësisë natyrore (tërmetit të shtatorit por edhe të 26 nëntori 2019);
- 1622 familje kanë marrë këstin e 4 të bonusit të qerasë kurse 4090 familje kanë marrë këstin e tretë (të dhënat janë të vlefshme për periudhën mars- mes prilli 2020)
- Deri në fund të muajit Mars, sipas burimeve rezultojnë që 2879 familjeve të prekura nga tërmeti në Bashkinë Durrës, kanë marrë këstin e tretë të bonusit të qirasë, që ka filluar të lëvrohet javën e 2 të Marsit. Ndërsa 3783 familje kanë marrë dy këstet e para dhe janë në pritje të të tretit, që do të bëhet gjatë muajit në vazhdim.
- Nga lista e bonusit të qirasë janë skualifikuar: 411 familje për shkak se shtëpitë e tyre janë klasifikuar të banueshme dhe 731 familje kanë mungesa në dokumentacion ndërsa pjesa e mbetur janë në shqyrtim.
- "Në muajt e parë të Prillit, sipas prononcimeve nga përfaqësues të Bashkisë Durrës rezultojnë që nga bonusi i qirasë po përfitojnë rreth 4000 prej qytetarë. Këshilli bashkiak i Durrësit ka miratuar tre lista me familjet që përfitojnë bonusin e qirasë. Në dy listat e para ishin përfituese 3863 familje, ndërkohë nga lista e miratuar në muajin shkurt përfitonin 1588 familje të tjera. Rreth 1500 aplikantë ende nuk kanë marrë asnjë kësht qiraje, pasi 420 janë skualifikuar përfundimisht duke qënë se banesat e tyre kanë dalë të banueshme, ndërsa 1070 të tjerë kanë mangësi në dokumentacionin e dorëzuar në bashki".
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, bazuar në donacione të njëpasnjëshme nga organizata e fondacione ka mundësuar ndihma për çdo familje në nevojë të identifikuar në të 5 njësitë administrative dhe 6 rajonet e Bashkisë Durrës. Nga kjo ndihmë deri më 19 Mars 2020, sipas të dhënave zyrtare kanë përfituar në total 2954 familje nga të cilat 1816 familje urbane/1138 familje në zonat rurale, të ndara sipas njësive administrative;

- Në Durrës, në vijim të operacionit humanitar të qeverisë në njësitë administrative Ishëm, Manzë, Sukth, Rrashbull dhe Katund i Ri janë shpërndarë ndihma për rreth 500 familje, mes të cilave familje që jetojnë në çadra që pas tërmetit të 26 nëntorit, familje në ndihmë ekonomike, pensionistë, të moshuar të vetmuar dhe persona me aftësi të kufizuar apo familje të pastreha. Gjithashtu gjatë këtyre ditëve janë trajtuar me ndihma nga Bashkia Durrës, 220 familje nga të cilat rreth 110 familje në nevojë, komuniteti rom dhe egjiptian, persona me aftësi të kufizuar, ku edhe me mbështetjen e organizatave të ndryshme janë shpërndarë pako ushqimore dhe higjienike. Po kështu bashkia Durrës vijon të trajtojë 110 të moshuar (qendra ditore e shërbimit social).
- Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, kanë kryesisht me ushqime dhe në disa raste edhe detergjentë higjienik si: Miell, oriz, sheqer, makarona, vaj, kripë, salcë, sapunë, shampo, ACE, pluhur larës për rroba.
- Përmbatja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasi dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nuk ka ndarje gjinore për shumë nga të dhënat që morëm nga bashkia Durrës. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikpamja gjinore;
- Ndarja gjinore pasqyrohet për nënkategoritë: a) Invalidë Pune b) Fëmijë me aftësi të kufizuar;
- Gjatë periudhës 10 mars - 10 prill, janë trajtuar 11 raste të reja të dhunës në familje, nga të cilat rezultojnë të jenë vetëm gra dhe zero burra. Nisur nga statusi i tyre rezultojnë të jenë nëna me fëmijë 9 prej tyre, dhe 8 në zona urbane dhe 2 në zonë rurale. Në të dhënat rezultojnë që një e dëmtuar nga dhuna nuk klasifikohet nëse i përket zonës urbane apo rurale;
- Deri në mes të muajit Prill 2020: 3100 familje përfitojnë pako me ndihma në Bashkinë e Durrësit.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

- Anëtarët e Komunitetit Rom dhe Egjiptian paraqiten si kategoria e cila më shumë nga të gjithë po e vuan situatën e pandemisë. Sipas të dhënave dhe burimeve rezultojnë që deri në datën 2 Prill 2020, janë vetëm 250 familje të komunitetit rom janë ndihmuar nga pakot ushqimore dhe higjienike. "Organizata World Vision Albania prej shumë ditësh në bashkëpunim me bashkinë e Durrësit është duke mbështetur me paketa ushqimore dhe higjienike 250 familje në nevojë në bashkinë e Durrësit, veçanërisht ato të njësive administrative 4 dhe njësisë 6 si dhe në njësinë administrative Sukth";
- Shërbimet Sociale pranë Bashkisë Durrës, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, lidhur me masat e marra në mbështetje të individëve dhe familje në nevojë përballë emergjencës së COVID-19, ka mundur identifikimin dhe kontaktimin e individëve/familjeve në nevojë;
- Ndërsa në zonat rurale një numër shumë i madh i paidentifikuar nxënësish nuk mund ta ndjekin mësimin me smart por vetëm përmes programeve që jepen në RTSh. Kjo është shumë e evidente nga intervistat me komunitetin në njësitë administrative Sukth, Manzë dhe Katund i Ri;

Rekomandime

- Duke qenë se Pandemia COVID-19 është një fatkeqësi natyre e veçantë, presim nga Bashkia Durrës të krijojë një protokoll për këto raste të replikueshëm për bashkitë e tjera;
- Bashkia Durrës duhet të aktivizojë të gjithë administratorët lokalë dhe stafet e tyre të identifikojnë dhe krijojnë në database për familjet dhe individët në nevojë;
- Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Durrës duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike;
- Ri-shikimi i fondeve apo lobimi pranë qeverisë për buxhete të cilat mund të vijnë në ndihmë të kategorive të cilat nuk janë parashikuara në VKM-të e mëparshme për ndihmë të shtresave në nevojë;
- Me anë të administratorëve të rajoneve të merren masa për afishimin e mënyrave të kontaktit të bashkisë Durrës për çdo problematikë nga grupet në nevojë apo pensionistët;
- Një vëmendje më e shtuar për kategorinë e komuniteteve Rom & Egjiptiane, sidomos për ato familje të cilat nuk kanë asnjë mundësi jetese përveç mbledhjes së plastikës dhe aluminit;
- Krijimi i mundësisë së bonusit të qerasë për të gjitha viktimat e dhunës në familje kur nuk janë mundësitë për ti akomoduar në Strehëzën Kombëtare;
- Forcimi i MKR-së dhe drejtimi i tyre për të qenë sa më aktivë dhe funksionalë në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe asaj gjinore;
- Lobimi në qeverinë qendrore për përfshirjen në VKM-të respektive të ndihmës edhe për target grupet si të rinjtë apo vajzat nëna;
- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm që edhe fëmijët e zonave rurale dhe ato të familjeve në nevojë të mund të pajisen me telefona smart, të cilat mund t ua lehtësojnë mësimnxënien.

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

<https://popalbania.info/raporti-i-monitorimit-bashkia-durres/>

● BASHKIA KUKËS ●

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

- Gjatë muajve shkurt, mars dhe prill janë 5100 familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga Bashkia Kukës, ndjekur nga 3089 individë përfitues me statusin e aftësisë së kufizuar;
- 333 familje janë përfituese të skemës së 6% të NE mbështetur nga Bashkia Kukës;
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Kukës, bazuar në donacione të njëpasnjëshme nga individë, biznese, organizata dhe fondacione, ka mundur ndihma për rreth 3000 familje në nevojë të identifikuar në të 15 njësitë administrative nga të cilat përbëhet. Nga kjo ndihmë deri më 30 prill 2020 kanë përfituar në total 3000 familje;
- Komuniteti jo rezident i Romëve në Kukës me qëndrim në zonën industriale janë mbështetur me 2 pako ushqimore në kohë të ndryshme dhe janë shpërndarë bukë falas për 15 ditë me rradhë.
- Bashkia Kukës ka ngritur platformën on line si mundësi shtesë të komunikimit me qytetarët;
- Bashkia Kukës ka ngritur 3 grupe punë për verifikimin e familjeve pretenduese dhe në bazë të informacioneve nga terreni. 250 vizita në familje janë realizuar në familje;
- Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, janë sic janë dhuruar dhe jo sipas standartit të miratuar nga Qeveria; Përmbatja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasi dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nuk ka ndarje gjinore për shumë nga të dhënat që morëm. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikpamja gjinore;
- Deri në 30 Prill janë realizuar dy pagesa për familjet në NE me 2 fish përfitimi; e njëjta skemë është realizuar edhe për familjet e përfshira në 6%.
- Bashkia Kukës nga buxheti i saj që nga fillimi i Emergjencës deri me datë 30 Prill ka shpenzuar 537,065 ALL për desinfektant dhe pako ushqimore.
- Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Shtetërore ka kontribut 0 gjatë gjithë kësaj periudhe.
- Mësimi "online" ka qenë përgjithsisht angazhues për mësuesit dhe nxënësit. Ka veshtirësi në shkollë në zona të thella dhe një numër i nxënësve ka patur mungesa të rëndësishme teknologjike.
- Drejtoria e Shërbimeve sociale bashkiake nuk disponon statistika gjinore për të rinjtë e të rejtat. Pasi në zbatim të vendimit nr. 236, datë 19.03.2020, të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", të rinjtë nuk janë ndër kategoritë e klasifikuara si shtresa në nevojë;
- Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave Kukës ka procesuar në kohë të shpejtë rastet dhe miratuar gjatë muajit prill. Nga të dhënat vihet re se ka një normë të lartë të mospërfitimit me rreth 40%.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

- Familjet në nevojë të kontaktuar shprehen se situata pandemike e ka bërë edhe më të vështirë mbijetesën e tyre. Pakot ushqimore të shpërndara nga pushteti vendor sipas tyre nuk janë të mjaftueshme dhe periudha e shpërndarjes duhet të jetë më e shpejtë; Paketat në asnjë rast (5 familje përfituese të intervistuar) nuk janë në përputhje me Vendimin e Qeverisë për sasinë dhe diversitetin e ushqimit që një pako duhet të përmbajë.
- Anëtarët e Komunitetit Rom në zonën industriale janë mbështetur me 2 pako ushqimore gjatë kësaj periudhe të cilat sipas tyre nuk janë të mjaftueshme;
- Përsa u përket pensionistëve, në përgjithësi pensionet ju shkojnë në shtëpi nga posta qendrore si dhe nga zyrat postare në njësitë administrative, por edhe fqinjët kanë ndihmuar në shumë raste si dhe njohjet personale brenda komuniteteve;
- Kukësi ka një fasoneri e cila ka vazhduar të funksionojë dhe nuk ka patur problem;
- Tre biznese të vogla të intervistuar kanë përfituar pagën e luftes edhe për punëtorin e siguruar. Problem kanë qenë biznese të cilat edhe pse të lejuara që të funksionojnë janë me gjiro zero dhe nuk janë përfitues të skemave të ndihmës.
- Shërbimet sociale pranë bashkisë Kukës, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, lidhur me masat e marra në mbështetje të individëve dhe familje në nevojë përballë emergjencës së COVID-19, si me njohjen e terreni ashtu edhe me mundësitë e kontaktimit on line apo me mjete të tjera të komunikimit, ka mundësuar identifikimin dhe kontaktimin e individëve/familjeve në nevojë. Administratorët e Njërive Administrative janë përgjegjës për territorin dhe familjet që janë mbështetur;
- Sipas intervistave të kryera sidomos me prindërit kuptohet se fëmijët nuk kanë hasur vështirësi në ndjekjen e leksioneve, por theksi bie në cilësinë, nxënien dhe frikën për provimet. Frikë kjo e cila ka ndjekur gjatë këtyre dy muajve edhe maturanët për provimet e lirit;
- Mësuesit e kontaktuar shprehin qëndrime të ndryshme. Një pjesë janë të kënaqur me procesin pasi ka patur angazhim të shtuar të nxënësve on line. Ndërkohë që verehet stres i shprehur nga pjesa tjetër si për ngarkesën, regjistrimin e videove dhe të qenit on line si dhe dozën e lartë të publicitetit. Ndërkohë që është e qartë vështirësia në zonat e thella rurale dhe për familjet e varfra.
- Për shkak se shkolla të ndryshme kanë libra të ndryshëm për të njëjtën lëndë, kontrinuti i TVSH është i diskutueshëm.

Rekomandime

- Duke qenë se Pandemia COVID-19 është një fatkeqësi natyre e veçantë, presim nga Bashkia Kukës të ndjekë protokolle të rrepta dhe të qarta për të gjithë popullatën;
- Bashkia Kukës duhet që në respekt të ligjit të kthejë përgjigje në kohë, dhe në detaje sipas kërkesave tona apo të palëve të tjera;
- Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Kukës duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike;
- Bashkia Kukës duhet të heqë dorë nga "Jemi të Varfër" dhe të përdorë fondet në dispozicion si të emergjencës ashtu dhe sipas ndryshimeve të bëra me vendim Këshilli;

- Rezerva Shtetërore duhet të kontribuojë me pako ushqimore sipas nevojës dhe nuk duhet të mbështet vetëm tek donacionet për Bashkinë Kukës dhe burimet e saj;
- Bashkia Kukës dhe Institucionet e tjera duhet të përgatiten për një fazë më të gjatë të mbështetjes, përfshirje në programet e tyre edhe të kategorive të tjera;
- Media në Kukës duhet të ri-startojë veten si media e lire, e pavarur dhe kritike;
- Organizatat dhe grupimet shoqërore në Kukës duhet që në mënyrë proaktive të luajnë rol të shtuar si me kontribut direkt ashtu edhe me kërkesë të transparencës.

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

<https://popalbania.info/raporti-i-monitorimit-bashkia-kukes/>

● BASHKIA KAMËZ ●

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

- Gjatë muajve shkurt dhe mars janë 524 familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga Bashkia Kamëz;
- 3270 individë të cilët trajtohen me pagesën e paaftësisë për punë, nga të cilët 603 fëmijë;
- 34 familje përfitojnë bonus qeraje;
- 170 burra dhe 39 gra përfitojnë bonus qeraje pas tërmetit të 26 nëntorit 2019;
- Bashkia Kamëz, bazuar në donacione të njëpasnjëshme nga organizata e fondacione ka mundur ndihma për çdo familje në nevojë të identifikuar në të gjithë territorin e bashkisë si dhe 2 Njësitë Administrative nga të cilat përbëhet. Nga kjo ndihmë deri më 27 prill 2020 kanë përfituar në total 3800 familje, nga të cilat 800 në njësitë administrative;
- Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, përmbajnë 24 kg miell, 4 kg oriz, 4 kg makarona, vaj, sheqer dhe 5 kg fasule) dhe 5 kg detergjentë, rezerva të përlllogaritura për 20 ditë;
- Nuk ka shtim të pagesave për personat me aftësi të kufizuar si dhe për ata me ndihmë ekonomike gjatë muajve mars dhe prill 2020;
- Gjatë periudhës 10 Mars - 27 Prill, janë trajtuar 28 raste të dhunës në familje nga të cilat 6 raste në zonat urbane dhe 22 në zonat rurale;
- Pas vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga Qeveria Shqiptare, janë identifikuar 280 persona të moshës së tretë të cilët jetojnë vetëm dhe që janë asistuar nga bashkia për plotësimin e nevojave të përditshme.
- Gjatë punës në territor me grupet e ngritura janë identifikuar 280 individë të papunë, nga të cilët 80 gra dhe 200 burra, të cilët të cilëve i është ofruar ndihmë ushqimore nga bashkia.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

- Prej intervistave të kryera me familjet në nevojë të kontaktuar nga SHIZI, del në pah se situata pandemike e ka bërë edhe më të vështirë mbijetesën e tyre.
- Edhe për anëtarët e komunitetit Rom & Egjiptian situata pandemike e ka bërë edhe më të vështirë mbijetesën e tyre. Disa prej tyre shprehen se kanë përfituar nga pakot e ushqimore, të cilat sipas tyre nuk janë të mjaftueshme.
- Punonjësit e padeklaruar, për shkak të kushteve nuk kanë përfituar nga "paga e luftës" dhe kanë mbetur pa të ardhurat kryesore për të mbajtur familjet.
- Punonjëset e fasonerive, për shkak të mbylljes së fabrikave nuk janë paguar për ditët e qëndrimit në shtëpi, duke bërë që të ardhurat e familjes të bien ndjeshëm. Ndërkohë ato që aktualisht janë në punë, raportojnë se stafi është ulur ndjeshëm dhe frika e infektimit është prezente.
- Pensionistëve, në përgjithësi pensionet ju dorëzohen në shtëpi nga punonjësit e postës. Gjithashtu, disa prej tyre shprehen se janë asistuar nga njësitë administrative dhe posta për pagesat e faturave kur nuk kanë pasur mundësi fizike.
- Shërbimet sociale pranë bashkisë, lidhur me masat e marra në mbështetje të individëve dhe familje në nevojë përballë emergjencës së COVID-19, ka mundësuar identifikimin dhe kontaktimin e individëve/familjeve në nevojë;
- Sipas intervistave të kryera, studentët në përgjithësi nuk kanë hasur vështirësi në ndjekjen e leksioneve, por theksi bie në cilësinë, pasigurinë dhe frikën për provimet. Ndërkohë e njëjta situatë nuk është për nxënësit, te të cilët vihet re një pamundësi më e madhe për të ndjekur mësimin online, duke bërë që një ta ndjekin atë përmes programeve që jepen në RTSh.

Rekomandime

- Bashkia Kamëz të punojë për Identifikimin e kryefamiljareve, punonjës fasonerish që kanë humbur punën dhe të mundësojë asistencën e tyre me ndihmë ekonomike deri në momentin e ri-fillimit të punës;
- Identifikimi dhe krijimi i një baze të dhënash për familjet dhe individët në nevojë të cilat duhet të asistohen nga Bashkia në këtë situatë pandemie, por edhe në vijim;
- Të shtohet vëmendja për familjet dhe individët e komuniteteve Rom & Egjiptiane, të cilat nuk kanë asnjë mundësi jetese përveç grumbullimit të materialeve të riciklueshme dhe asistimi i tyre;
- Në kuadër të shkëputjes nga shkolla të asistohen familjet në nevojë, fëmijët e të cilëve nuk kanë akses në pajisje teknologjike apo internet, nëpërmjet donatorëve të ndryshëm për ti lehtësuar mësimin.

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

<https://popalbania.info/raporti-i-monitorimit-bashkia-kamez/>

● BASHKIA VLORË ●

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

- Bashkia Vlorë aktivizoi Komisionin e Mbrojtjes Civile dhe grupet e vlerësimit në terren që bënë identifikimin e familjeve dhe individëve në nevojë.
- Informimi i qytetarëve është realizuar në mënyrë periodike përmes mediave lokale dhe mediave sociale online. Në dispozicion të qytetarëve janë vendosur 4 numra celulari të dedikuar si dhe kontaktet e kryetarëve të rajoneve dhe drejtorëve të drejtorive, të publikuara në faqen e internetit të bashkisë.
- Në Bashkinë Vlorë, janë 789 familje (563 zonën urbane/ 226 zonat rurale), përfituese të ndihmës ekonomike (nga të ardhurat e bashkisë, fondi i kushtëzuar 6% dhe sistemi dixhital) për muajin shkurt, që në muajin mars 2020, në bazë të urdhërit nr.92/4 datë 27/03/2020, përfituan dyfish pagesën e ndihmës ekonomike.
- Janë ndihmuar me paketa të ndihmës ushqimore rreth 60 familje që janë pjesë e NE, si dhe përfitues të pagesës së Aftësisë së Kufizuar, nga të cilat 37 familje në zonat e thella rurale dhe 23 familje në qytet.
- Gjatë muajit mars 11 persona më shumë, përfituan pagesën e paaftësisë për punë (KEMP), në një total prej 1630 persona, nga të cilët 1157 jetojnë në zonë urbane dhe 473 në zonën rurale.
- 35 familje përfitojnë subvencionimin e qerasë (bonusi i qerasë) për muajin prill 2020.
- Për tremujorin e parë deri në fillim të muajit prill 2020, janë trajtuar nga Koordinator Vendor i Njesisë së Dhunës në Familje dhe Barazisë Gjinore, 22 raste të reja të dhunës në familje.
- 157 familje është numri i komunitetit rom dhe egjiptian në bashkinë e Vlorës të ndihmuar, nga të cilat 30 familje janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, bonusit të qerasë dhe pas datës 9 mars edhe 127 familje përfituan paketën e ndihmës ushqimore, konkretisht 67 familje rome në NJA Novoselë dhe 60 familje rome në NJA Shushicë.
- 11 individë me statusin e jetimit dhe 210 nëna kryefamiljare në Bashkinë e Vlorës, trajtohen me ndihmën financiare, ndërsa nuk ka të dhëna për ndihma të tjera.
- Bashkia ka asituar rreth 1000 të moshuar përmes ndihmës për të të blerë ushqimet, ofrimin të ilaçeve të rimbursueshme dhe ofrimi i pakove ushqimore.
- Shumë individë të papunë, gjatë izolimit janë drejtuar bashkisë Vlorë për përfitimin e pakove ushqimore, në muajt mars- prill, kërkesat janë administruar përmes rajoneve.
- Ndarja e ndihmave ushqimore, ka nisur më datë 25.03.2020 dhe brenda marsit janë shpërndarë 1340 pako ushqimore. Puna në terren ka rrezultuar me riklasifikim të familjeve dhe për muajin prill janë miratuar pako të ndihmave për 1193 familje nga të cilat 693 të referuara nga sektori i Ndihmës Sociale dhe për 500 familje do të shpërndahen, pas verifikimeve rast pas rasti dhe aprovimit në Komisionin Qendror për Ofrimin e Asistencës.
- Paketot ushqimore përmbajnë ushqimet më të nevojshme dhe për muajin mars kishte vlerën 2,058 lekë/pako, në muajin prill janë shtuar edhe detergjentë dhe vlerësohet 3083 lekë/pako ushqimore.

- Bashkia është ndihmuar edhe nga donatorë privatë si Fundjava Ndryshe, Eurosig, Big Market, K.a Trading Albania Shpk, INSIG, Hipermarket Haso, Hotel Regina dhe disa njësi të vogla tregëtare, të cilat kanë shpërndarë ushqime në familjet e identifikuar nga administratorët e rajoneve dhe të pa trajtuar me fondet e vetë bashkisë. Donatorët privatë kanë mbuluar rreth 430 familje me ndihma, gjatë muajit mars.
- Në të dhënat e siguruara nga Bashkia Vlorë, për disa shërbime të ofruara, mungon ndarja gjinore. Nuk ka informacione në lidhje me numrat dhe shërbime drejtuar të rinjve në izolim.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

- Ka ankesa për të drejtat e lëvizjes ose shërbime që ofrohen ekskluzivisht nga bashkia, jo të gjitha planet e masave dhe aktet e miratuara, kanë qënë të deklaruara nga institucionet vendore.
- Komunikimi përmes rrjeteve sociale përbën bazën e komunikimit, duke anashkaluar mediumet publike që ka për detyrë bashkia, ti bëjë publike ndaj qytetarëve.
- Përsa i përket ndihmës ekonomike dhe ushqimore, qytetarët shprehen se Bashkia ka shumë pak mundësi ti ndihmojë dhe shprehen se nuk kanë mundësi të përfitojnë edhe nëse aplikojnë në periudhën e izolimit, ose pas saj.
- Pensionistët deri diku shprehen pozitivë ndaj vëmendjes së treguar për ta, ata konfirmojnë se disa shërbime i marrin nga bashkia, por kanë gjetur dhe mbështetje nga të afërm të tyre.
- Komuniteti rom dhe egjiptian, mbetet në kërkim të vazhdueshëm të mbështetjes ushqimore dhe financiare, ata përballen me vështirësi të mëdha.
- Nga intervistat e realizuara me grupe të ndryshme qytetarësh shprehet qartë pasiguria dhe shqetësimi mbi situatën e vështirë ekonomike që janë duke përjetuar. Familjet në nevojë, që trajtohen me ndihmë financiare dhe pako ushqimore, kërkojnë që informacioni të mbërrijë në kohë dhe mbështetja të jetë e vazhdueshme.
- Të punësuarit në sektorin e shërbimeve, nuk kanë informacion nëse do të arrijnë të përfitojnë ndihmën financiare të vendosur nga Qeveria Qendrore, por më shumë janë të shqetësuar nëse do të kenë mundësi të rikthehen në punë, pas përfundimit të periudhës së izolimit.
- Sektori i biznesit, manifeston shqetësime rreth impaktit ekonomik dhe social, jo vetëm në aktivitetin e tyre, por për gjithë bashkepunëtorët dhe partnerët e tyre. Të gjithë janë të mendimit se kjo periudhë e izolimit do të sjellë ndikime afatgjata. Edhe pse janë në djeni të masave lehtësuese dhe disa prej tyre kanë përfituar, ata rekomandojnë mbështetje më të madhe nga qeverisja qendrore dhe ajo lokale.
- Ndërsa nxënësit dhe studentët, janë më pak të shqetësuarit, por manifestojnë lodhje me procesin e të mësuarit on line, probleme emocionale dhe sociale, që mbeten ende pa u trajtuar në periudhën e izolimit.

Rekomandime

- Situata e izolimit dhe pandemisë së COVID-19, vendosi institucionet dhe qytetarët para sfidave që kërkojnë ndërhyrje të shpejtë, të koordinuar dhe inteligjente.
- Bazuar mbi situatën, kërkohet zgjidhje dhe adresim i unifikuar për periudhën e daljes nga izolimi, ku komunikimi në kohë reale dhe bashkëpunimi mes qytetarëve dhe Bashkisë Vlorë, të jetë sa më cilësor dhe efektiv.
- Bashkia duhet të ndryshojë buxhetin e vitit 2020, fondet duhen të përshaten dhe të ri shpërndahen, për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe qytetarëve që rrezikojnë të mbeten të papunë pas periudhës së izolimit.
- Gjithë të dhënat e grumbulluara mbi qytetarët që kanë nevojë për mbështetje, nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Administratoret e Njësive dhe Komisioni i Mbrojtjes Civile, duhet të unifikohen dhe orientohen drejt përgjigjes së shpejtë me ndihmë financiare ose ushqimore. Rekomandohet të krijohet një fond i nevojshëm për të adresuar me ndihmë financiare/usqimore, këto kategori.
- Rritja e mbështetjes për komunitetin rom dhe egjiptian përmes paketave ushqimore.
- Shërbimet që mund të ofrohen online për qytetarët, janë të rekomanduara të fuqizohen dhe të përdoren formate sa më të thjeshta. Bashkia duhet të investojë për mediumet zyrtare të shpërndarjes së informacionit, sic është faqja zyrtare e internetit, ku qytetarët të marrin informacion dhe shërbime në kohë reale.
- Edhe pse Bashkia nuk është përgjegjëse e drejtëpërdrejtë për punësimin e qytetarëve, ajo duhet të ketë në vëmendje, përmes ngritjes së iniciativave për punësimin e individëve që do të preken nga kriza e COVID-19.
- Mbështetje për sektorin e turizmit, përmes lehtësimit të taksave dhe tarifave, krijimit të mjedisit të sigurt për përdoruesit dhe iniciativave bashkëpunuese, në fuqizimin e sektorit që mbështet gjithë ekonominë qarkulluese në Bashkinë Vlorë.
- Mbështetje emocionale, artistike dhe kreativiteti, për fëmijët dhe të rinjtë, përmes programeve të aktiviteteve online.

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

<https://popalbania.info/raporti-i-monitorimit-bashkia-vlore/>

● BASHKIA POGRADEDEC ●

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

- Bazuar në informacionet zyrtare dhe monitorimin e bëre nuk rezulton asnjë rast me COVID 19 në Pogradec, duke e bëre një nga zonat e gjelbra.
- Gjatë muajve Shkurt dhe Mars 4498 familje kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike nga Bashkia Pogradec. Nga këto, 720 familje janë ndihmuar edhe me shërbime të tjera nga Bashkia.
- Jane 5031 persona që trajnohen me Kemp nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMACP) nga të cilat 2566 janë burra dhe 2465 gra. 169 persona nga kjo kategori janë mbështetur dhe me shërbime të tjera.
- Përgjate muajit Mars dhe Prill janë raportuar tre raste dhune në familje, të treja nga gra.
- Sipas të dhënave zyrtare janë 5540 familje nga Komuniteti Rom & Egjiptian në Pogradec dhe në rrethinat e tij.
- Janë 7 persona me statusin e Jetimit në Bashkinë Pogradec prej të cilëve 5 janë burra dhe 2 gra.
- Janë vetëm 2 raste të vajza-nëna në Bashkinë Pogradec.
- Janë asistuar me shërbim të ndryshme 1512 pensionistë. Nga keto Bashkia Pogradec ka identifikuar rreth 128, pensionistë që jetojnë vetëm dhe që familjarët ju jetojnë jashtë. Nuk kemi informacion për ndarjen gjinore por sipas Bashkisë janë me projeksion më të madh të gjinisë mashkullore.
- Sipas monitorimit të faqes zyrtare të Bashkisë Pogradec në FB nga data 1 Prill deri me datë 30 Prill rezulton që: nëpërmjet bashkëpunimit me organizata, fondacione dhe biznese të ndryshme, Bashkia Pogradec ka mundur pajisjen me pako ushqimore të 2675 familjeve nga zona dhe kategori të ndryshme të Pogradecit.
- Përmbatja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasi dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nga i njefti burim (faqja zyrtare në FB) mësojmë që Bashkia Pogradec në bashkëpunim me biznese të ndryshme ka marrë përsipër furnizimin me 3 vakte ngrënie të 55 shtetasve shqiptarë që janë të akomoduar tek Hotel Euro Korça në Pogradec për 14 ditë.
- Sipas të dhënave nga Bashkia rezulton që për muajin Mars nr. i familjeve që i janë shpërndarë ndihma dhe i janë ofruar shërbime të ndryshme është 2593.
- Nuk ka ndarje gjinore për shumë nga të dhënat që morëm nga bashkia Pogradec. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikëpamja gjinore.
- Ndarja gjinore pasqyrohet për nënkategoritë: a) Personat që trajtohen me Kemp b) Jetime c) rastet e dhunës në familje.
- Nuk ka shtim të pagesave për personat me aftësi të kufizuar si dhe për ata me ndihmë ekonomike gjatë muajit mars 2020.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

- Sipas intervistave në Gur të Kuq, ku ndodhen rreth 50 familje Rome & Egjiptiane, ato shprehen që janë ndihmuar me pako ushqimore nga OJF dhe kanë mbetur të kënaqur nga përmbatja.
- Gjithashtu nga intervista të tjera me qytetarët që kanë përfituar pako ato shprehen të kënaqur nga pako që kanë marrë nga Bashkia. (1 pako përmbante ushqimet bazë të shportës, 1 thes me miell, vaj, sheqer, kripë, makarona, oriz dhe detergjentë)
- Sipas intervistave me familjarët dhe personat me AK, rezulton që pagesa ka kaluar pa problem dhe nuk ka pasur as ulje as rritje të saj.
- Sipas intervistave me personat që përfitojnë nga ndihma ekonomike rezulton që ka pasur dyfishim të kësaj pagese për muajin Mars 2020.
- Sipas intervistave me qytetarët nuk ka pasur probleme në marrjen e pensionit dhe Bashkia ka venë në dispozicion një nr. tel (për çdo njësi administrative një person/ numër telefoni përgjegjës) për të dërguar pensionet në shtëpi.
- Pjesa më e madhe e nxënësve që jetojnë në qytet dhe në fshatrat afër qytetit e kanë ndjekur mesimin në distancë.
- Qytetarët shprehen që në fillim ishin të frikësuar dhe mosbesues por i kanë mbështetur masat dhe shpresojnë që ekonomia të rimekembet sa më parë.

Rekomandime

- Bashkia Pogradec duhet të krijojë një database të dhënash sipas çdo kategorie në nevojë dhe gjithashtu të aktivizojë punonjësit e tij për të regjistruar personat nga grupet vulnerable apo kategori të tjera që nuk rezultojnë në asnjë database;
- Bashkia Pogradec në kuader të transparence duhet të updatejë vendimet e Këshillit Bashkiak në uebsite të tyre dhe prane kanaleve të tjera si vendime.al;
- Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Pogradec duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike;
- Ri-shikimi i fondeve apo lobimi pranë qeverisë për buxhete të cilat mund të vijnë në ndihmë të kategorive të cilat nuk janë parashikuara në VKM-të e mëparshme për ndihmë të shtresave në nevojë;
- Një vëmendje më e shtuar për kategorinë e komuniteteve Rome & Egjiptiane, sidomos për ato familje të cilat nuk kanë asnjë mundësi jetese përveç mbledhjes së plastikës dhe aluminit;
- Lobimi në qeverinë qendrore për përfshirjen në VKM-të respektive të ndihmës edhe për target grupet si të rinjtë apo vajzat nëna;
- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm që edhe fëmijët e zonave rurale dhe ato të familjeve në nevojë të mund të pajisen me telefona smart, të cilat mund t'ua lehtësojnë mësimnxënien.
- Forcimi i MKR-së dhe drejtimi i tyre për të qenë sa më aktivë dhe funksionalë në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe asaj gjinore.
- Forcimi i bashkëpunimit me efektiv të insitucioneve të ndërvlerësive për një punë më efektive dhe transparente.

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

<https://popalbania.info/raporti-i-monitorimit-bashkia-pogradec/>

● BASHKIA SHKODËR ●

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

- 1824 familje janë trajtuar me ndihmë ekonomike gjatë muajit Mars (1639 familje nga sistemi dhe 185 familje nga fondi 6%).
- 32 familje më pak se në muajin Shkurt janë trajtuar me ndihmë ekonomike gjatë muajit Mars
- 4363 është numri i personave që trajtohen me KEMP nga të cilët të paaftë 2568, kujdestarë të të pa-aftëve 475, të verbër 520, kujdestarë të të verbërve 132, tetra/ paraplegjikë 337, kujdestarë të tyrë 331.
- 3401 invalide pune për muajin Mars janë trajtuar me shtesë kempit. Nga këta 2485 i përkasin qytetit Shkodër.
- Thirrja për aplikime për programet e strehimit social, për shkak të situatës emergjente të shkaktuar nga COVID-19, është pezulluar deri në një datë për tu përcaktuar. Si rezultat i kësaj situatë edhe programi i bonusit të strehimit është i pezulluar, si pjesë e programeve të strehimit social
- 140 kërkesa janë bërë nga qytetarët pranë zyrave me një ndalesë në qendër dhe njesitë administrative për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019. Numri më i madh i kërkesave i perket njësisë Administrative Velipojë. Nga këto 34 objekte janë rradhitur sipas vlerësimit të pasqyruar në aktet e konstatimit, duke marrë në konsideratë shkallën e rrezikshmërisë dhe nevojën prioritare për ekspertizë të thelluar. Bashkia Shkodër i ka dërguar Prefekturës së Qarkut Shkodër informacion të detajuar për vlerësimin e ndertesave publike dhe private, të demtuara gjatë tërmetit.
- 4 raste të reja të dhunës në familje janë trajtuar me urdhër mbrojtje.
- 135 familje të komunitetit rom të vendosur në vendqendrimet pranë Prokurorisë, Zallit të Kirit, përtej Bunës, pranë lumit Drin, Tophanë dhe në Beltojë janë mbështetur me paketa ushqimore dhe higjienike.
- 352 familje egjiptiane të vendosura në lagjen Liria dhe përtej urës së Bunës janë mbështetur me paketa ushqimore dhe higjienike.
- 100 persona të moshës së tretë që jetojnë vetëm dhe në veshtirësi janë identifikuar të cilëve i janë ofruar pako ushqimore dhe higjienike, shërbimin e blerjeve së produkteve të ndryshme sipas nevojës, informacion për procedurën e terheqjes së pensionit, të sigurimit të medikamenteve, etj.
- 30 jetimë me dhe pa status janë mbështetur me produktet bazë të shportës por edhe me keshillim për fëmijët e tyre sipas nevojës.
- 2270 familje kanë marrë ndihma 1351 prej tyre jetojnë në zona urbane dhe 919 në zona rurale
- Bashkia Shkodër nuk ka informacion për numrin e të rinjve të rikthyer nga jashtë në Shqipëri duke qenë se ky informacion nuk është dhënë nga Ministria e Brendshme apo Drejtoria e Kufirit.
- Bashkia komunikon në mënyrë të rregullt në lidhje me masat e marra nëpërmjet faqes së internetit ose në rrjetin facebook

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

Nga intervistat me kategoritë e caktuara rezulton se:

- 90% e të intervistuarëve të cilët punojnë në fasoneri theksojnë se nuk kanë masat e nevojshme parandaluese
- 68% e familjeve në nevojë shprehen se nuk kanë mjete financiare për të përballuar pagesat
- 85% e administratorëve të bizneseve shprehën se nuk përballojnë pagesat e qirave, taksat dhe sigurimet shoqërore për punonjësit e tyre.
- 55% e të punësuarve shprehën se kanë pasiguri në punë si dhe për të ardhmen e tyre
- 77% e personave me aftësi të kufizuara kërkojnë më tepër mundësi për të dalë në ajër të pastër.
- 65% e grave familjare kërkojnë më tepër liri dalje si dhe lehtësira në ofrimin e shërbimeve dhe pagesave
- 88% e komunitetit Rom dhe Egjiptian shprehën se ndihmat nuk janë të mjaftueshme dhe nuk janë shpërndarë në mënyrë të barabartë.
- 76% e studentëve/nxënësve shprehën se qëndrimi në shtëpi nuk krijon kushtet e duhura për tu përqëndruar në studimin dhe përvetësimin e lëndëve. Mësimin online nuk e quajnë si të përshtatshëm në këtë kohë pandemie.
- 92% e sportistëve dhe artistëve të intervistuar ndihen të braktisur pa ndihmë financiare si dhe pa kushtet e duhura.
- 64% e pensionistëve vlerësojnë masat por kërkojnë më tepër hapësirë për të levizur në ajër të pastër.

Rekomandime

- Bashkia Shkodër duhet që të krijojë në këtë situatë emergjente të gjithë mekanizmat e nevojshëm për të marrë mendimin e qytetarëve dhe grupimeve të ndryshme duke krijuar një frymë solidariteti me baze në komunitet
- Duhet gjetur të gjitha mënyrat e mundshme për angazhimin e komunitetit për të siguruar stabilitet, efektivitet në zbatimin e masave dhe në shmangien e çdo forme ndëshkimore
- Krijimin e të gjitha kushteve të duhura për qytetarët që të mbrojnë shëndetin e tyre dhe të komuniteteve nga frika prej papunësisë, kostove të kujdesit shëndetësor, mungesës së infrastrukturës sanitare dhe kështu me radhë.
- Të sigurohet qasje në përkujdesje falas ose të përballueshme për personat më të prekshëm dhe më të vështirë për tu arritur.
- Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Shkodër duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike;
- Kufizimet e ndermarra duhet të jenë për një kohë sa më të shkurtër duke krijuar të gjitha kushtet dhe mundësitë e duhura që qytetarët të punojnë, të marrin shërbime dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre.
- Rishikimi i buxhetit duhet të bëhet në mënyrë të kujdesshme dhe të argumentuar duke patur gjithmonë si prioritet gjithpërfshirjen e komuniteteve në mjetet e domosdoshme për jetesë.

- Në këtë periudhë është e nevojshme që të menjahet retorika politike dhe në fokus të jetë shërbimi ndaj qytetarëve duke i dhënë atyre besimin e nevojshëm për të përballuar këtë emergjencë në menyrë dinjitoze.
- Komuniteti Rom & Egjiptiane, dhe sidomos për ato familje të cilat nuk kanë asnjë mundësi jetese duhet që të trajtohen në menyrë prioritare duke shikuar mundësinë e ndihmës jo vetëm me pako ushqimore por edhe me mjete financiare
- Duhet të krijohen mundësi për ofrimin e shërbimeve psikologjike dhe ligjore për viktimat e dhunës në familje, grupet vulnerable për të parandaluar raste të dhunës në familje, shtimit të kriminalitetit apo edhe abuzimeve me alkolin dhe drogat.
- Masat kufizuese duhet krijohet mundësia që zbatimi i tyre mos të jetë vetëm nëpërmjet policisë bashkiake por edhe me ndërgjegjësimin e qytetarëve;
- Ndërverprimi me shoqërinë civile të rritet duke mos u fokusuar thjeshtë në shpërndarjen e pakove ushqimore por edhe në realizimin e shërbimeve dhe lehtësimin e aksesit për grupet në nevojë për përfitimin e këtyre shërbimeve
- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm që edhe fëmijët e zonave rurale dhe ato të familjeve në nevojë të mund të pajisen me telefona smart, të cilat mund t'u lehtësojnë mësimin nën.
- Një vëmendje e veçantë duhet adresuar ndaj komunitetit të sportistëve dhe artistëve të cilët kanë nevojë jo vetëm për mbështetje financiare por edhe për mbështetje morale duke qenë se janë kthyer në një komunitet plotësisht jashtë vëmendjes.

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

<https://popalbania.info/raporti-i-monitorimit-bashkia-shkoder/>

● BASHKIA PUKË ●

Gjetje nga përgjigjet e bashkisë

- Përgjatë periudhës së COVID 19 bashkia Pukë ka vijuar punën intensive me marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së virusit në të gjithë territorin e bashkisë përmes:
- Ndërgjegjësimin e komunitetit për respektimin e masave
- Vendosjen e të gjithë aseteve në kuader të respektimit të këtyre masave
- Dizenfektimet periodike të hapsirave publike në qytet dhe në njësitë administrative
- Dizenfektimin e institucioneve arsimore sipas urdhërimit të ministrisë së shëndetësisë
- Dizenfektimin e institucioneve të vartësisë
- Dizenfektimin e pikave të kuqe (mjediseve rreth banesave dhe fshatrave ku janë evidentuar raste Covid pozitiv)
- Patronazhimin e të gjithë të moshuarve të cilët jetojnë vetëm vazhdimisht, apo gjatë kësaj periudhe në territorin e bashkisë së Pukës
- Trajtimin me pako ushqimore, higjienike dhe miell të moshuarve në vetmi dhe familjeve me vështirësi ekonomike
- Transportin e medikamenteve në familjet që kanë pasur nevojë në të gjithë territorin e bashkisë Pukë.
- Transportin e bazës ushqimore dhe materialeve të tjera nga bashkia sipas kërkesës së banorëve nga të gjitha fshatrat
- Ndhimë për shpërndarjen e pensioneve apo asistencën për likuidimin e faturave sipas kërkesës nga vetë familjet e asistuar gjatë kësaj periudhe.
- Gjatë muajve shkurt dhe mars janë 422 familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike nga Bashkia Pukë.
- Persona të trajtuar me pagesën e paaftësisë janë 273 nga të cilët 122 gra
- Gjatë periudhës së pandemisë e deri me 16 Prill bashkia Pukë ka trajtuar me ndihma në paketa ushqimore e detergjente 400 familje dhe puna vazhdon,
- Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, përmbajnë produktet bazë të shportës si: miell, oriz, sheqer, makarona, vaj ushqimor, kripë, salcë domatesh, detergjent, sapun.
- Gjatë periudhës së pandemisë bashkia ka identifikuar 81 persona të cilët jetojnë vetëm dhe janë patronazhuar e trajtuar me pako ushqimore e higjienike dhe medikamente nga bashkia.
- Numri i personave me statusin e jetimit janë 6
- Vajza dhe gra me trajtim të veçantë janë 3 edhe këto dy kategori kanë gjetur mbështetjen nga bashkia në kohën e pandemisë,

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

- Familjet në nevojë të kontaktuar shprehen se situata pandemike e ka bërë edhe më të vështirë mbijetesën e tyre. Paketat ushqimore të shpërndara nga pushteti vendor sipas tyre nuk janë të mjaftueshme dhe periudha e shpërndarjes duhet të jetë më e shpeshtë, në disa familje ka pasur vetëm një pako ushqimore ndërsa ka

disa familje që mund të kenë marrë dhe një pako ndihme të dytë, ne disa familje rezultojnë se për shkak të punës sezonale kryefamiljarët janë larguar në vende të rajonit dhe më gjërë ku në fakt janë ndeshur me izolim ndërkohë familjet e tyre janë përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike e po ashtu nuk kanë përfituar as pakon e ndihmës, duke i vënë në vështirësi të thelluar këto familje.

- Përsa u përket pensionistëve, në përgjithësi pensionet ju shkojnë në shtëpi nga zyra e postës në bashkëpunim me drejtuesit e njësive administrative.
- Personat me aftësi të kufizuar si dhe ata që përfitojnë KEMP nga shteti, pensionistët dhe të pamundurit në përgjithësi janë kontaktuar në mënyrë të vazhdueshme nga punonjësit e bashkisë për nevojat e mundshme që kanë pasur, por ka dhe nga ata që shprehen se askush nuk ka ndihmuar për situatën ku ato ndodhen.
- Zyra e ndihmës ekonomike, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, lidhur me masat e marra në mbështetje të individëve dhe familje në nevojë përballë emergjencës së COVID-19, ka mundur identifikimin dhe kontaktimin e individëve/familjeve në nevojë;
- Grupet e terrenit të patronazhimit në çdo njësi administrative dhe qytet, të cilat përbëhen nga stafe punonjësish sociale dhe vullnetarë, kanë përditësuar listat emërore të personave nën patronazhim (deri në datë 16 prill 2020);
- Sipas intervistave të kryera në zonen urbane që është qyteti Pukë me lagjet rrotull, prindërit u shprehën se fëmijët nuk kanë hasur vështirësi në ndjekjen e mesimeve online, në të shumtën e rasteve të pyeturit në njësitë administrative zonat rurale nuk kanë pasur mundësi të marrin mësimet online për shkak se zonat nuk janë të mbuluara me internet dhe ofertat kanë qenë të shtrenjta pasi ka familje me 2 ose 3 fëmijë që marrin mësimet njëherazi dhe mungesa e aparateve celulare apo kompjuterave e bën të pamundur vijueshmërinë e mësimet.
- Po ashtu e vetmja mundësi për zonat e thella ka qenë ndjekja e mesimeve përmes programeve që jepen në TV - Shqiptar, deri diku e vlefshme pasi siq e dime përzgjedhja e teksteve për mësimet e vitit nuk është e njëjtë për të gjitha shkollat e republikës së Shqipërisë.

Rekomandime

- Duke qenë se Pandemia COVID-19 është një fatkeqësi natyre e veçantë, presim nga Bashkia Pukë të aktivizojë njësitë administrative dhe stafet e tyre të identifikojnë dhe krijojnë në database për familjet dhe individët në nevojë;
- Mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Pukë duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike;
- Ri-shikimi i fondeve apo lobimi pranë qeverisë për buxhete të cilat mund të vijnë në ndihmë të kategorive të cilat nuk janë parashikuara në VKM-të e mëparshme për ndihmë të shtresave në nevojë;
- Identifikimi i kryefamiljareve, punonjësve që kanë humbur punën dhe mbështetja e tyre me asistencë sociale apo ndihmë ekonomike deri në momentin e ri-fillimit të punës;

- Me anë të punonjësve apo rrjeteve të informimit të merren masa për njoftimin e mënyrave të kontaktit të bashkisë Pukë për çdo problematikë nga grupet në nevojë apo pensionistët,
- Forcimi i Mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës dhe drejtimi i tyre për të qenë sa më aktivë dhe funksionalë në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe asaj gjinore;
- Lobimi në qeverinë qendrore për përfshirjen në VKM-të respektive të ndihmës edhe për target grupet si të rinjtë apo vajzat nëna dhe nënat kryefamiljare
- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm që edhe fëmijët e zonave rurale dhe ato të familjeve në nevojë të mund të pajisen me mjete teknologjike që të mundësojnë pjesmarrjen online në procesin mësimor.
- Mosvlersimi i kamat-vonesave gjatë kohës së pandemisë.

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

<https://popalbania.info/raporti-i-monitorimit-bashkia-puke/>

● BASHKIA FIER ●

Gjetje nga të dhënat që solli bashkia

- Gjatë muajve shkurt, mars dhe prill janë 503 familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike.
- Numri i personave që trajtohen me KEMP (invalidë pune) për të gjithë Bashkinë Fier është 3019, nga të cilët 1719 janë burra dhe 1300 gra.
- Numri personave të paaftë për punë është si vijon: PAK 2094 persona; Verbëri 702 persona; Paraplegji 328 vete.
- Gjatë muajve shkurt, mars dhe prill regjistrohen 22 përfitues me statusin e jetimit çdo muaj, 12 vajza dhe 10 djem. Përveç ndihmës ekonomike, e cila është dyfishuar për këtë periudhë, janë mbështetur me ndihma ushqimore edhe nga fondacione të ndryshme.
- Në Bashkinë Fier trajtohen me pagesën e Ndhmës Ekonomike 3 vajza-nëna, banuese në qytet.
- Gjatë muajve janar, shkurt, mars dhe prill janë trajtuar nga MR Fier 29 viktima të dhunës në familje (10 raste në janar, 8 raste në shkurt, 4 në mars dhe 7 raste në prill).
- Trendi i rasteve të dhunës në familje, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë rezulton më i ulët (në zbritje), i dukshëm në muajin mars. Ky muaj rezulton me shifrën më të ulët në të gjithë vitet e kaluara.
- Deri në datën 9 Mars në Bashkinë Fier nuk ka patur asnjë familje që trajtohej me bonus qeraje. Pas kësaj date janë rregjistruar 20 familje.
- Në bashkinë Fier ka vetëm një rast të dëmtimit të banesës nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Banesa ndodhet në zonë rurale (në fshatin Kraps, NjA Portëz) dhe rregjistronte vetëm disa dëmtime të riparueshme. Ky rast u kalua në Këshillin Bashkiak Fier dhe u miratua një fond për riparimin e dëmeve nga tërmeti. Rasti tashmë është trajtuar.

- Asnjë prej përfituesve të shportave ushqimore nuk është i kategorisë "i pastrehë pas tërmetit të 26 Nëntorit 2019".
- Bashkia Fier (nga fondi i bashkisë), nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit Social në muajin mars ka shpërndarë 1000 shporta ushqimore për familjet në nevojë në të gjithë territorin e saj.
- 326 familje në Bashkinë Fier kanë përfituar shporta ushqimore falas nga qeveria. Bashkia Fier, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit Social, bazuar në donacione nga organizata e fondacione ka mundësuar ndihma për rreh 1800 familje në nevojë të identifikuar në të gjitha njësitet administrative (13 NjA), të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kategoritë përfituese sipas VKM Nr. 236 datë 19.03.2020 dhe VKB date 27.03.2020.
- Paketat ushqimore të ndihmës gjatë pandemisë COVID-19, përmbajnë produktet bazë të shportës si: miell, oriz, sheqer, makarona, vaj ushqimor, kripë, salcë domatesh, fasule, detergjent, sapun, dizinfektues;
- Përmbatja e paketës ushqimore nga të tretë ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasi dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nuk ka ndarje gjinore dhe territoriale për shumë nga të dhënat që morëm nga Bashkia Fier. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikpamja gjinore dhe territoriale;
- Ka dyfishim të pagesës së ndihmës ekonomike për muajin mars sipas Vendimit Nr.254, datë 27.3.2020.
- Nuk ka shtim të numrit të familjeve/individëve përfitues të NE.
- Drejtoria e Shërbimeve sociale bashkiake nuk disponon statistika gjinore për të rinjtë e të rejtat. Pasi në zbatim të vendimit nr. 236, datë 19.03.2020, të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19", të rinjtë nuk janë ndër kategoritë e klasifikuara si shtresa në nevojë;
- Gjatë periudhës 10 mars - 30 prill, kur lëvizja e qytetarëve ka qenë e penguar trajtimi i viktimave të dhunës në familje është bërë nëpërmjet komunikimit dhe koordinimit virtual. Është bërë shoqërimi i tyre në momentet finale pranë familjarëve të tjerë, si prindërit, motra, vëllezër. Gjatë kësaj periudhe është mbajtur një komunikimin i vazhdueshëm me administratorët social, SPZ e rajoneve, fshtreve, sipas vendbanimit të viktimave dhe familjarëve të tyre.
- Viktimat e dhunës në familje që trajtohen me NE nga UM, por jo vetëm janë paguar për muajin mars me pagesë të dyfishuar, sipas vendimit të qeverisë. Gjithashtu ato janë mbështetur edhe me paketa ushqimore.
- Numri total i familjeve rome & egjiptiane në Bashkinë Fier është 595.
- Familjet rome që kanë përfituar pako ushqimore sipas VKM 236 dt 19.03.2020 (që trajton të gjitha familjet në skemen e NE) është 60 familje.
- Këshilli i Bashkisë Fier, më datë 27.3.2020 miratoi kërkesën e ardhur nga vetë komuniteti për mbështetjen e 382 familjet rome në nevojë, të cilat nuk përfitonin nga VKM 236 datë 19.03.2020.
- Komuniteti rom ka përfituar edhe 664 shporta ushqimore falas nga donatorë të tjerë gjatë muajve mars dhe prill.
- Një tjetër mision i Bashkisë Fier ka qenë dhe shërbimi për të gjithë grupet e riskuara nga COVID-19, me qëllim mosdaljen e tyre nga banesa. Gjatë periudhës 10 mars-30 prill, Bashkia u ka ardhur në ndihmë 3890 pensionistëve, duke u dërguar pensionin në shtëpi, medikamentet, ushqimet, apo pagesat e faturave të ndryshme.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë

- Pothuajse të gjithë familjet e kontaktuar janë shprehur se kjo situatë pandemike i ka kapur jo vetëm të papërgatitur, por e ka bërë shumë të vështirë mbijetesën e tyre. Familjet e kontaktuar, të cilat janë trajtuar me shporta ushqimore, apo ndihma nga qeverisja vendore janë shprehur se ato janë të pamjaftueshme, kurse familjet që nuk janë trajtuar me ndihma janë shprehur se e kanë të pamundur mbijetesën pasi rrugët e tjera që ata kishin si burim të adhurash (nga fëmijët emigrantë, aktivitetet ambulante, etj.) tashmë janë mbyllur.
- Pavarësisht se komuniteti Rom & Egjiptian është trajtuar vazhdimisht me shporta ushqimore falas nga njësia e qeverisjes vendore dhe donatorë të ndryshëm, mbetet kategoria që duket se po e vuan situatën e pandemisë më shumë nga të gjithë. Nga intervistat e kryera në këto komunitete del si problematikë pamjaftueshmëria e ushqimeve që përmbajnë shportat ushqimore dhe periudha e largët e shpërndarjes së tyre.
- Pensionistët janë shprehur se janë kontaktuar nga punonjës të bashkisë për tu ofruar shërbime të ndryshme si: blerjen e ushqimeve, medikamenteve, apo dërgimin e pensionit në shtëpi. Në përgjithësi ky lloj shërbimi është mbuluar nga Bashkia. Problem ka qenë deri diku për pensionistët që e merrnin pensionin në bankë, pasi nuk lejohej veprimi nga të tretë. Ky problem është zgjidhur nga një urdhër i brendshëm i bankës dhe marrëdhënieve të ngritura me postën shqiptare për dërgimin e tyre pranë qytetarëve.
- Gratë të cilat punojnë me ditë pranë familjeve të ndryshme për pastrim shtëpie që nga data 9 mars kanë mbetur pa të ardhurat kryesore për të mbajtur familjet. Pak nga ato që janë në skemën e NE janë shprehur se dyfishimi i NE për muajin mars u ka ardhur në ndihmë edhe pse ende mbetet e pamjaftueshme;
- Problematike ka qenë situata e grave të punësuar në sektorin e fasonerisë. Nga 10 të intervistuar 3 kanë qenë të detyruara të përballen me rrezikun çdo ditë. 6 prej tyre nuk kanë punuar më pas shpalljes së pandemisë pasi fabrika është mbyllur, kurse një ka hequr dorë nga puna për shkak të fëmijës së vogël, pasi kopshtet janë mbyllur. Asnjë prej tyre nuk ka marrë ndihmë apo pagë lufte. 2 nga 10 kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe janë në pritje të përgjigjes.
- PAK si dhe ata që përfitojnë KEMP kanë hasur një periudhë vonese në pagesën e pensionit të tyre (periudha e mbylljes së degës së Thesarit Fier pasi punonjëset u karantinuan pas infektimit me COVID-19 të njërës prej tyre), por kanë deklaruar se kempit nuk iu është ndërprerë, gjithashtu janë trajtuar edhe me pako ushqimore.
- Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Fier në bashkëpunim me Rajonet, Administratorët e Njësive dhe kryepelqët e fshatrave, në zbatim të akteve ligjore në fuqi, lidhur me masat e marra në mbështetje të individëve dhe familje në nevojë përballë emergjencës së COVID-19, ka mundur identifikimin dhe kontaktimin e individëve/familjeve në nevojë, si dhe pensionistët e vetmuar;
- Nga intervistat e bëra në Bashkinë Fier, mësohet se në datën 12 Mars ka nisur asistimin 10 grupe pune, të cilët kontaktonin nëpërmjet telefonit pensionistët e vetmuar, për ti pyetur nëse kishin ndonjë problem dhe për ti ofruar shërbimet, në zbatim të VKM 236 dt 19.03.2020 (Kategoritë e familjeve që përfitojnë shërbime). Paralel me këto grupe funksiononin dhe grupet e terrenit (patronazhimit), të cilët shpërndanin shërbimet atje ku kërkohet.

- Bazuar në 10 intervistat e kryera me prindër në qytet, 6 prej tyre janë shprehur se fëmijët e tyre nuk kanë hasur vështirësi në ndjekjen e mësimin on line. 3 prej tyre janë shprehur se janë ndier të kufizuar në angazhime të tjera të rëndësishme, pasi fëmijët përdornin celularët e tyre për të shkëmbyer videot, për të kryer testet semestrale, apo projektet/detyrat e portofolit dhe 1 prind është shprehur se e ka patur të pamundur që fëmijët të ndiqnin mësimet nëpërmjet internetit. Të gjithë ishin skeptikë për cilësinë e mësimdhënies dhe efikasitetin e kësaj praktike, reflektimi i së cilës do të shfaqet në rezultatet e provimeve të lirisimit/maturës.
- Nga 10 intervistat e kryera me të rinjtë, vetëm 2 prej tyre, të cilët ishin banorë të zonave rurale, për shkak të mungesës së aksesit të internetit nuk kanë mundur të ndjekin mësimin on line. Nga hulumtimet e bëra, bazuar në këtë fokus rezultoi se pjesa më e madhe e nxënësve të grupmoshës 7 - 10 vjeç nuk kanë mundur të ndjekin mësimin online. Nxënësit e grupmoshës 10 - 18 vjeç në zonat rurale e kanë ndjekur pjesërisht. Një pjesë e këtyre nxënësve kanë ndjekur programet mësimore të transmetuara nga RTSh.

Rekomandime

- Kjo situatë pandemie (COVID-19) nxori në pah mungesën e një protokollit për një fatkeqësi natyrore të veçantë. Mbështetur në këtë fakt jemi në pritje të reflektimit të Bashkisë Fier për krijimin e një protokollit bazuar në të gjitha eksperiencat pozitive dhe negative edhe të bashkive të tjera;
- Përsheptimi i procesit të decentralizimit të bashkive, e cila do të fuqizonte më shumë buxhetet dhe planet konkrete të veprimtimit në bazuar në specifikat e zonës.
- Krijimi i një database për familjet dhe individët në nevojë në të gjithë territorin e Bashkisë Fier, ndarë sipas zonave, specifikave sociale, gjinisë. Për procesin e identifikimit dhe vlerësimit social duhet angazhimi i administratorëve socialë lokal, administratorët e NJA, Kryepelqët e fshatrave dhe administratorët e pallateve.
- Identifikimi i tyre, mbledhja e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore/territoriale është një domosdoshmëri që bashkia Fier duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike, pasi është një mungesë që duhet plotësuar;
- Lobimi pranë qeverisë për përfshirje më të madhe të kategorive përfituese (shtresa në nevojë), përveç atyre të specifikuar në VKM-të e nxjerra gjatë situatës pandemike, pasi shumë familje në nevojë ngelën pa mbështetje, duke marrë parasysh edhe buxhetet e kufizuara të bashkive;
- Lobimi në qeverinë qendrore për përfshirjen në VKM-të respektive të ndihmës edhe për grupet e tjera në nevojë si: të rinjtë apo vajzat nëna, edhe pse këto të fundit janë trajtuar nga fondet e bashkisë, apo donatorë;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për identifikimin e kryefamiljarëve të papunë, me qëllim përfshirjen e tyre në mbështetjen lokale ose qendrore.
- Identifikimi i punonjësve që kanë humbur punën, me qëllim dhënien e asistencës për të aplikuar për ndihmë ekonomike dhe mbështetja e tyre me shporta ushqimore deri në momentin e rifillimit të punës;
- Asistencë për aplikime të programeve të ndryshme mbështetëse online për komunitetet Rome & Egjiptiane, si dhe shtimi i mbështetjes ushqimore kryesisht për ato familje që nuk kanë asnjë mundësi jetese përveç mbledhjes së plastikës dhe aluminit;

- Krijimi i mundësisë së bonusit të qerasë në masën 100%, për të gjitha viktimat e dhunës në familje kur nuk janë mundësitë për ti akomoduar në Strehëzën Kombëtare;
- Forcimi i MR-së dhe drejtimi i tyre për të qenë sa më aktiv dhe funksional në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe asaj gjinore;
- Gjetja e një mënyre për ti ofruar arsim të barabartë të gjithë nxënësve, përfshirë këtu edhe ata të zonave rurale, ose shtrirja e bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm për sigurimin e mjeteve të komunikacionit si: telefona smart, l-pod, apo tablet.
- Bashkëpunim më i ngushtë me bankat e nivelit të dytë; ofrimin në kohë të pagesave nga këto të fundit, si dhe lehtësi procedurale për dërgimin e tyre pranë qytetarëve të kategorizuar "grupe në risk".

Raportin e plotë mund ta lexoni në:

https://popalbania.info/wp-content/uploads/2020/05/Raporti_Bashkia-Fier_COVID-19-1.pdf

* Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: "Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social". Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjinore per Zhvillim, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- "Intelektualët e Rinj Shpresë", Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec.